



Plani i Zhvillimit Strategjik për periudhën 2021-2023
Instituti i Shëndetit Publik

**Plani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për
periudhën 2021-2023**

Përbajtja

I.	HYRJE	3
	PARATHËNIE	3
	PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT	4
II.	MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT	5
	MOTOJA	5
	MISIONI	5
	VIZIONI 2023	5
	VLERAT	5
III.	DREJTIMET STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT	7
	SHËNDETI DHE SFIDAT MADHORE TË SHËNDETIT PUBLIK	7
	SISTEMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR	9
	KËRCËNIMET SERIOZE PËR SHËNDETIN DHE MBROJTJA E SHËNDETIT	13
	SHËRBIMI KOMBËTAR I INFORMACIONIT SHËNDETËSOR	15
	MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	19
	KUALIFIKIMI I PROFESIONISTËVE TË SHËNDETIT PUBLIK	21
	KËRKIMI SHKENCOR NË SHËNDET PUBLIK	22
	NDËRTIMI I PARTNERITETEVE	23
	BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	23
IV.	ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI	25
	ZHVILLIMI/KUALIFIKIMI I PUNONJËSVE	25
	PËRDITËSIMI I PROCESIT KRYESOR DHE ATYRE MBËSHTETËSE	26
	SIGURIMI I FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM	27
V.	MONITORIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE	28

I. HYRJE

PARATHËNIE

Shëndetit i atribuohet vlera më e lartë në shumicën e shoqërive bashkëkohore, meqenëse përbën parakusht përritjen e mirëqenies. Sigurimi i shëndetit optimal për popullsinë, e për pasojë i jetëgjatësisë, është detyrë e gjithë shoqërisë. Shëndeti publik, në përgjithësi, përkufizohet si veprimtaritë që duhen garantuar nga shoqëria për sigurimin e kushteve të mjaftueshme dhe të një mqedisi ku njerëzit janë të shëndetshëm. Shumë vende u ngarkojnë disa nga këto detyra instituteve të shëndetit publik të cilët ofrojnë ekspertizë përvendimmarrjen që lidhet drejtpërdrejt apo tërthorazi me shëndetin. Prandaj, në punën e tyre, ekspertët e shëndetit publik përqendrohen në shëndetin e popullatës dhe në faktorët që ndikojnë në shëndetin, si gjatë menaxhimit të sëmundjeve ngjitetë dhe të jo të transmetueshme, ashtu dhe në hartimin e politikave që synojnë përmirësimin e shëndetit.

Në Shqipëri, Institutit të Shëndetit Publik (ISHP), i është dhënë roli kryesor në menaxhimin e shëndetit publik në rang kombëtar. ISHP jep të dhëna mbi shëndetin dhe kujdesin përritë; monitoron dhe vlerëson shëndetin publik; identifikon kërcënimet për shëndetin dhe harton masat përzbutjen e tyre; synon të përmirësojë shëndetin publik dhe të garantojë ekspertizën përvendimmarrjen promovuese të shëndetit; përgatit programe dhe masa për parandalimin e sëmundjeve; ndjek dhe vlerëson sistemet e kujdesit shëndetësor; punon për kualifikimin profesional të ekspertëve të shëndetit publik dhe ndërmerr kërkime shkencore në fushën e shëndetit publik. ISHP përbën bazën e ekspertizës që mbështet vendimet e Qeverisë të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi ndikojnë në problemet e shëndetësisë në nivel kombëtar apo lokal.

Vitet e fundit veprimtaritë për shëndetin publik janë shtuar, sidomos vitet e pandemisë SARS COVID 19, i kanë dhënë ISHP-së funksione menaxheriale duke e vënë në fokus të politikave shëndetësore mbarëkombëtare (ndërsa fushëzbatimi, që është tepër ndërdisiplinor, është bërë më kompleks). Përveç kësaj edhe pritshmëritë e shoqërisë dhe të individëve janë rritur, meqenëse kërkohet një angazhim proaktiv i shtetit dhe i institucioneve të tij, si dhe përgjigje aktive përkërsesë të larmishme. Pritet që ISHP të furnizojë me të dhëna dhe informacion që ndihmon në forcimin e shëndetit, të menaxhojë sfida të mëdha të shëndetit publik që synojnë përmirësimin e shëndetit të të gjithë popullsisë dhe të rrisë cilësinë dhe gjatësinë e jetës.

Plani i Zhvillimit Strategjik i ISHP-së për 2021-2023 përcakton misionin, vizionin dhe vlerat e saj; përkufizon/paraqet fushat e zhvillimeve dhe qëllimeve strategjike përritë periudhë dhe veprimtaritë konkrete përritjen e tyre. Në hartimin e dokumentit paraprak morën pjesë shumica e drejtuesve të ISHP-së, ndërsa vërejtjet (inputet) e partnerëve kyç na kanë ndihmuar përritësimin e vizionit dhe të përparësive (prioritetave) tonë strategjike, si dhe në përkufizimin e vlerave që do të nxisin veprimtaritë në vijimësi. Gjatë këtij procesi, kemi marrë parasysh zhvillimet e fundit të doktrinës dhe eksperiencave në fushën e shëndetit publik.

Ne besojmë që ky dokument do të ndihmojë në përpilimin e planeve vjetore të zbatimit dhe të na udhëzojë në vendimmarrjen individuale për zhvillimet.

**Plani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për
periudhën 2021-2023**

PËRMBAJTJA E DOKUMENTIT

Kapitulli i dytë i këtij dokumenti prezanton misionin, vizionin dhe vlerat e ISHP-së, të cilat u hartuan gjatë shumë diskutimeve që përfshinë drejtuesit kryesorë, si dhe seminareve (workshop-ve) me pjesëmarrës shumicën e personelit. Ky ndiqet nga kapitulli kryesor që përcakton drejtimet strategjike - çelës: sfidat e rëndësishme të shëndetit publik, kërcënimet për shëndetin dhe sistemet shëndetësore. Secili përfshin një pëershkrim të shkurtër, cakton synimet për 5 vitet në vijim dhe paraqet strategjitet për arrijen e tyre. Kapitulli i katërt përcakton funksionet që mbështesin drejtimet kyç. Funksionet mbështetëse paraqiten me objektivat e lidhur me to dhe strategjitet për arrijen e tyre. Kapitulli i fundit paraqet metodat e monitorimit të vënies në zbatim (implementimit) të PZHS-së.

II. MISIONI,VIZIONI DHE VLERAT

MOTOJA

Dija është çelësi për një shëndet më të mirë.

MISIONI

ISHP është e angazhuar për të kontribuar për një mirëqenie dhe shëndet sa më cilësor të banorëve të Republikës së Shqipërisë.

Bashkë me partnerët, ISHP është burim i të dhënave dhe informacioneve kyç përvendimmarrjen dhe veprimtarinë e individëve dhe ekspertëve, si dhe përpilimin e politikave shëndetësore. ISHP identifikon sfidat e shëndetit publik për popullsinë, përfshirë determinantët që ndikojnë në shëndet dhe propozon masa përmirësimin e shëndetit.

ISHP monitoron sistemin e mbrojtjes të shëndetit publik, përgatit analizat e funksionimit të sistemit, propozon masat përfunksionimin dhe konsultimin më të mirë te tij, si dhe zhvillimet prioritare (parësore). ISHP identifikon rreziqet potenciale për shëndetin dhe përgatit masat përmirësimin e mbrojtjen e tij. Nëpërmjet kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, ISHP kontribuon për zbulime të reja, popullarizon dijet e reja dhe praktikat pozitive.

VIZIONI 2023

ISHP është një institucion me autoritet që ushtron ndikim të rëndësishëm në shëndetin publik kombëtar dhe në zhvillimin e sistemit të kujdesit shëndetësor të Shqipërisë. ISHP është partneri më i rëndësishëm në programet dhe projektet e orientuara në përmirësimin dhe mbrojtjen e shëndetit. ISHP ofron punësim në një mjeshtëri të kënaqshëm dhe inkurajes.

VLERAT

Përgjegjësia dhe përgjegjshmëria: ISHP i përgjigjet nevojave aktuale të popullsisë. Për arritjen e objektivave të përbashkëta, ISHP zbaton njohuri të bazuara në fakte dhe praktikat më të mira. Personeli i ISHP-së është i përkushtuar për plotësimin e misionit të Institutit nëpërmjet sjelljes së ndershme, etike dhe profesionale. Ata pranojnë përgjegjësinë personale për punën dhe vendimet e tyre profesionale, dhe gjithmonë e kudo bëjnë avokatinë e shëndetit kombëtar.

Respekti reciprok, bashkëpunimi dhe kualifikimi i personelit të ISHP: Personeli i ISHP-së karakterizohet nga respekti reciprok dhe bashkëpunimi në sigurimin e një mjeshtëri të krijues pune. ISHP promovon arsimimin e brendshëm e të jashtëm, vetarsimimin, ngritjen profesionale, zhvillimin e talenteve dhe ofron mbështetje dhe asistencë/udhëheqje shkencore të kualifikuar. ISHP plotëson nevojat e veta, si dhe kompetencat e nevojat individuale. ISHP vlerëson përpjekjet dhe kontributin e çdo individi dhe të çdo eksperti. Opinionet e ndryshme vlerësohen dhe shkëmbohen në një dialog të hapur. Së bashku me eksperientat e reja, ato jepin mundësinë e përfitimit të njohurive bashkëkohore. Si ekspertët, ashtu dhe individët e tjera të personelit, kërkojnë vazhdimit mundësi të reja për arritjen e synimeve personale dhe

Plani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2021-2023

profesionale në mënyrë plotësisht të sinkronizuar me direktivat strategjike dhe objektivat e ISHP-së në dobi të shëndetit publik.

Sigurimi i aksesit dhe transparenca: ISHP-ja garanton aksesin e publikut dhe transparencën për veprimtaritë, punën dhe vendimet e veta. ISHP-ja është e hapur për bashkëpunim dhe lidh partneritete me individë, ekspertë dhe vendimmarrës për plotësimin e kërkesave dhe arritjen e synimeve. ISHP-ja promovon ndërdisiplinaritetin dhe shumëdisiplinaritetin, si dhe shkëmbimin e ideve dhe të informacionit. ISHP-ja identifikon dhe prezanton praktikat e dobishme; e bazon veprimtarinë e vet dhe investon tek njohja dhe reputacioni në Shqipëri dhe jashtë vendit.

III. DREJTIMET STRATEGJIKE TË ZHVILLIMIT

Shëndeti publik është një nocion mjaft i gjërë, i cili nuk ka një përkufizim të saktë ndërkombëtar. Përgjithësisht, termi përfshin tërësinë e funksioneve që një shtet duhet të kryejë për të garantuar të gjitha kushtet për jetën e shëndetshme të banorëve të tij. Funksionet e shëndetit publik realizohen nga shteti nëpërmjet veprimtarisë së administratës shtetërore dhe veprimtarisë së institucioneve të shëndetit publik, në bashkëpunim me institucionet e tjera publike. ISHP si institucion kombëtar qendror i shëndetit publik, vepron në fushat e shëndetit publik dhe veprimtarive të ngjashme me rëndësi të veçantë. ISHP përcakton objektivat e zhvillimit duke kontribuar në kryerjen e funksioneve kryesore të shëndetit publik.

SHËNDETI DHE SFIDAT MADHORE TË SHËNDETIT PUBLIK

Analiza e shëndetit dhe determinantëve të shëndetit është më tepër se sa thjesht mbledhja e të dhënavë dhe hartimi i indikatorëve bazë. Ajo synon që të përcaktojë problemet kryesore të shëndetit publik në popullatë, duke përfshirë determinantët që ndikojnë në shëndet, paraqitjen e trendeve dhe, mbi të gjitha, parashikimin.

Analizat e shëndetit publik nuk shtrihen aq gjërësish sa duhet. Fakti se ato zakonisht mbështeten në të dhëna nga mbledhjet rutinë të informacionit paraqet një tjetër vështirësi. Për arsyet e burimeve të raportimit, të dhënat kryesisht paraqesin funksionimin dhe aktivitetet e shërbimit të kujdesit shëndetësor dhe jo prevalencën e një sëmundjeje në popullatë. Në të shkuan, ISHP pothuaj asnjëherë nuk ka vlerësuar shëndetin publik mbështetur në mbledhjen e të dhënavë me qëllim të caktuar (p.sh. me anë të anketimeve) nga studimet epidemiologjike. ISHP ende nuk ka realizuar ndonjë studim të plotë mbi shëndetin e popullatës adulte shqiptare, të tipit Anketa Europiane e Shëndetit bazuar në Intervistë ose Anketa Europiane e Shëndetit bazuar në Ekzaminim (EHIS, ose EHES). Por, janë realizuar anketime të ngjashme të stilit të jetesës (për shembull, Studimi Demografik dhe Shëndetësor i Shqipërisë 2017-2018).

Mangësia kryesore e analizave të shëndetit është mungesa e ekspertëve me kualifikimin e duhur në profile të ndryshme, që nga specialistët e shëndetit publik – analistë, ekspertë IT dhe statisticienë/metodologjistë – deri tek modernizimi i të dhënavë rutinë dhe realizimi i studimeve epidemiologjike.

Me të dhënat e disponueshme, ISHP përgatit informacionin mbi prevalencën e sëmundjeve të caktuara dhe lidhjen ndërmjet nivelit të incidencës dhe/ose prevalencës me determinantët ekonomikë, socialë, mjedisorë e të tjera.

Analizat e shëndetit janë mjete për të njobur fushat prioritare për veprim. ISHP luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e informacionit që ndihmon individët për të bërë zgjedhjen e duhur për shëndetin e tyre, në mënyrë që të ndihmojë ekspertët në formulimin e programeve dhe politikave shëndetësore duke synuar të ofrojnë politika dhe mjesid që promovojnë shëndetin.

Programet e përmirësimit shëndetësor, të planifikuar dhe zhvilluar nga ISHP, kanë për qëllim kryesisht parandalimin e shkaqeve të sëmundjeve kronike, me faktorë risku të përbashkët (veçanërisht, abuzimi me alkoolin dhe duhanin, dieta e pashëndetshme, aktiviteti i ulët fizik, dhe shëndeti mendor), dhe nxitjen e faktorëve parandalues të rrezikut për shëndetin për grupe të veçanta të popullatës, si dhe masa strukturore që përcaktojnë kushtet e jetesës. Në mënyrë indirekte, këto masa do të ndihmojnë në parandalimin e sëmundjeve kronike.

Duke marrë në konsideratë vdekshmérinë dhe indikatorët e prevalencës, dy fusha të tjera strategjike të përmirësimit të shëndetit janë parandalimi i aksidenteve dhe promovimi i shëndetit seksual dhe atij riprodhues. Në çdo program dhe projektpozim, ISHP do të ketë parasysh parimet e gjithëpërfshirjes në shëndet dhe uljen e pabarazisë.

Qëllimi strategjik 1: Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë ravigjëzuar dhe dakordësuar një sistem për garantimin e informacionit të përditësuar mbi shëndetin e popullatës shqiptare, determinantët (përcaktorët) e shëndetit, dhe masave për përmirësimin e shëndetit.

Strategjia 1.1. Vodosja e standardeve të raportimit në sigurimin e informacionit përvlerësimin e shëndetit dhe determinantëve shëndetësorë:

- Zhvillimi i një strategje survejance afatgjatë;
- Standardizimi i survejancës dhe zhvillimi i indikatorëve;
- Zhvillimi i modeleve të survejancës për sëmundje të veçanta në përputhje me priorititet.

Strategjia 1.2. Analiza e sfidave që paraqesin tendencat e shëndetit publik për të bërë të mundur marrjen e masave të duhura:

- Analiza periodike deskriptive e të dhënave në kohën e përshtatshme për sfidat individuale;
- Përfshirja e modeleve të reja të analizës për të kuptuar fushat prioritare të parandalimit; zhvillimi i modelimit të tendencave dhe parashikimi i sfidave individuale në shëndet publik.

Strategjia 1.3. Raportimi mbi shëndetin, sëmundjet dhe determinantët e shëndetit dhe masat e propozuara:

- Përgatitja e informacionit për individët në mënyrë që ata të marrin vendime të duhura për shëndetin e tyre;
- Përgatitja e informacionit për të ndihmuar ekspertët në formulimin e programeve;
- Përgatitja e informacionit që ndihmon në formulimin e politikave shëndetësore dhe vendimtarries;
- Raporte të shkurtra mbi shëndetin, të paktën çdo dy vjet, me theks të veçantë në të paktën një risk të shëndetit publik;
- Një raport të detajuar shëndetësor çdo 5 vjet, që përfshin të gjitha problemet kryesore, duke përfshirë tendencat për 10-15 vitet e fundit dhe gjithashtu,
- Një vlerësim të shëndetit publik dhe programeve të ndërhyrjes, me parashikim të tendencave të ardhshme;
- Hartimi i rekomandimeve për menaxhimin efektiv ose të përmirësuar të sfidave të shëndetit publik.

Qëllimi strategjik 2: Deri në vitin 2023, ISHP do të jetë burimi më i rëndësishëm i informacionit dhe partneri kryesor për sektorë të ndryshëm, sa i përket informacionit të politikave shëndetësore dhe programeve të përmirësimit të shëndetit.

Strategja 2.1. Zhvillimi i programeve të përmirësimit të shëndetit që synojnë nxitjen e faktorëve parandalues të shëndetit në grupe të veçanta të popullatës, si dhe masa strukturore bazuar në kushtet e jetesës; programe zhvillimi që synojnë parandalimin e shkaqeve të sëmundjeve kronike (kryesish abuzimi me alkoolin dhe duhanin, dietën e pashëndetshme, aktivitetin e ulët fizik dhe shëndetin mendor);

- Zhvillimi i programeve të përmirësimit të shëndetit për grupe individësh në popullatë me qëllim që:
 - Të ulen pabarazitë në shëndet;
 - Të zhvillohen programe për parandalimin e aksidenteve.

Strategja 2.2. Propozimi për projekte dhe programe me prioritet kombëtar:

- Përcaktimi i prioriteve kombëtare të shëndetit publik dhe programeve të përmirësimit të shëndetit, duke u bazuar në gjetjet e raporteve shëndetësore periodike dhe vjetore;
- Përgatitja e propozimeve për sektorë të ndryshëm dhe rolit të tyre në fushën ligjore dhe strukturore;
- Vlerësimi i politikave të propozuara dhe sugjerimi i ndryshimeve.

SISTEMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

ISHP e sheh veten aktiv në dy aspekte të kujdesit shëndetësor: si burim të dhënat dhe informacioni rrëth funksionimit të kujdesit shëndetësor, dhe si koordinator i kujdesit shëndetësor në drejtim të parandalimit.

Vlerësimi i funksionimit të kujdesit shëndetësor dhe propozimet për përmirësim mund të ndihmojnë shumë në promovimin e politikave shëndetësore, që lidhen me vendimet organizative dhe priorititetet e zhvillimit.

ISHP duhet të jetë në gjendje të ofrojë **analiza bazë dhe propozime** për funksionimin e aktiviteteve të kujdesit shëndetësor, të tilla si: përcaktimi i numrit të stafit, projektme financiare dhe të nevojave për shërbime të kujdesit shëndetësor, analizën e funksionimit të sistemit të kujdesit shëndetësor; të cilat aktualisht nuk ofrohen në cilësinë e duhur. Gjithashtu, në të ardhmen, ISHP duhet t'i kushtoje vëmendje të veçantë zhvillimit dhe përdorimit të indikatorëve të cilësisë dhe eficiencës së kujdesit shëndetësor, dhe aktiviteteve që lidhen me të.

Aksesi ndaj kujdesit shëndetësor dhe diferençat në këtë aspekt mbeten një drejtim i rëndësishëm i zhvillimit, si nga pikëpamja e determinantëve socio-ekonomikë, ashtu dhe disponueshmërisë së personelit të kujdesit shëndetësor.

Sa i përket cilësisë së kujdesit shëndetësor, ISHP sapo e ka nisur këtë veprimtari. Megjithatë, ky është një drejtim i rëndësishëm i zhvillimit. Roli i ISHP-së do të jetë që të ofrojë një sistem transparent të indikatorëve kombëtarë, i cili mund të përdoret si bazë për zhvillimin dhe survejancën e aktiviteteve të kujdesit shëndetësor.

Shpenzimet dhe analiza ekonomike janë elementë të rëndësishëm të vendimmarrjes. Vlerësimi i kosto-efektivitetit dhe i kosto-përfitimit është veçanërisht i rëndësishëm përpara aplikimit të ndërhyrjeve të reja në shëndet publik. Specialistët e Shëndetit Publik duhet të

vlerësojnë nevojat në rritje për Shëndet të një popullate diverse me buxhete financiare të limituara. ISHP duhet të fuqizojë kapacitetet njerëzore dhe teknologjike për të kryer studime bazuar mbi modele ekonomike, për të ekzaminuar kostot e inputeve me kostot e rezultateve. ISHP do të veprojë si bashkëpunëtor i ekspertëve dhe institucioneve të ndryshme në fushat përkatëse duke ndihmuar politikëbërësit me të dhëna dhe evidenca në vlerësimet ekonomike të ndërhyrjeve dhe investimeve për shëndetin e popullatës.

Menaxhimi i programeve parandaluese dhe depistuese duhet të riorganizohet pothuaj tërësisht nga e para. Në të shkuarën, roli i ISHP-së në hartimin dhe survejimin e kontrolleve (check up-eve) parandaluese tek fëmijët, gratë gjatë shtatzënisë dhe në periudhën pas lindjes, ka qenë relativisht i njojur dhe i ndjeshëm. Gjatë viteve të fundit, ky rol u zbeh disi, megjithëse aktualisht është e dukshme nevoja në rritje për një përfshirje më të madhe të ISHP-së. Një aspekt që aktualisht funksionon mirë është menaxhimi i programeve depistuese të sapofilluar për zbulimin e hershëm të sëmundjeve kanceroze, në veçanti kancerit të gjirit. Ka vjuar ndjekja dhe menaxhimi i shërbimeve të mamografive lëvizëse, duke filluar nga informimi i grave e deri tek interpretimi i rezultateve të mamografive, në bashkëpunim me Sektorin e Promocionit të Shëndetit, me Operatorët Rajonalë të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe me QSUT-në. Bazuar në VKM-të përkatëse, që prej vitit 2019 ka filluar zbatimi në shkallë kombëtare i programit të organizuar të depistimit të kancerit të qafës së mitrës përmes testit HPV, si test primar në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor. Programi zbatohet në grup-moshat 40-49 vjeç. Gjithashtu, bazuar në VKM-në e vitit 2020 "Për Miratimin e Paketës së Programit të Depistimit të Kancerit të Gjirit në Shqipëri", do të zbatohet Korniza Teknike e Programit të Depistimit të Kancerit të Gjirit dhe do të vijoje koordinimi i punës me spitalet rajonale dhe qendrat e mamografive fiksë për zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit. Programi i parandalimit primar të sëmundjeve kardiovaskulare po rezulton më pak i suksesshëm, por sidoqoftë në nivel të kënaqshëm duke marrë në konsideratë kompleksitetin e problematikës së lidhur me këtë grup sëmundjesh. Në këtë drejtim mbetet i rëndësishëm organizimi vjetor i fushatës "May Measurement Month" për depistimin e hipertensionit arterial (HTA) në popullatë; organizimi i një fushatë të integruar me aktorët e industrisë dhe tregtisë mbi kontrollin e kripës në bukë përmes bashkëpunimit ndërsektorial; si dhe organizimi i një fushatë ndërgjegjësimi mbi konsumin e kripës në popullatë në bashkëpunim me sektorin e promocionit shëndetësor. Një aktivitet tjetër i rëndësishëm është dhe vlerësimi i situatës dhe i efikasitetit të ndërhyrjeve të mundshme lidhur me uljen e yndymave të satruara dhe sheqerit të shtuar në mënyrë industriale, si dhe eliminimin e trans-fat në ushqimet e tregtuara.

Lidhur me shëndetin e të moshuarve mbetet i një rëndësie të veçantë zbatimi i planit kombëtar të veprimit mbi moshimin dhe organizimin e ndërhyrjeve specifike në këtë fushë, si dhe përgatitja e kurrikulave dhe e standardeve për kujdesin mbi të moshuarit në nivele të ndryshme të sistemit shëndetësor.

Me qëllim parandalimin e sëmundjeve jo të transmetueshme në popullatë, janë të rëndësishme ndërhyrjet që në moshat fëminore dhe në adoleshencë. Por për këtë qëllim nevojitet fillimi i një punë kërkimore në fushën e shëndetit të fëmijëve, adoleshentëve dhe të rinjve në vendin tonë nëpërmjet zhvillimit të studimeve kombëtare lidhur me sjelljet e rrezikshme shëndetësore tek fëmijët dhe të rinjtë e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme. Për realizimin e ketyre studimeve nevojitet dhe mbështetja e partnerëve të tjera kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Kontrollet (check up-et) parandaluese dhe të zbulimit të hershëm të sëmundjeve përfshijnë nuk ofrojnë informacionin e përshtatshëm, pasi nuk survejohen në nivel kombëtar dhe prandaj nuk mund të përdoren si platformë për përgatitjen e programeve të përmirësimit. Po

bëhen përpjekje serioze për ngritjen e sistemit të survejancës së praktikave të ushqyerjes përfmijët 0-2 vjeç dhe indikatorët e rritjes dhe zhvillimit përfmijët 0-5 vjeç, dhe shtrirjen e këtij sistemi në të gjithë vendin. E njëjtë gjë është e vërtetë për disa programe ekzaminuese, si ekzaminimi i grave shtatzëna për infeksionin e toksoplazmozës dhe për kontrolllet parandaluese të punëtorëve.

Të gjitha gjetjet e rëndësishme duhet të kihen parasysh për zbatimin efektiv dhe me sukses të programeve depistuese. Një përgatitje dhe zbatim i dobët i programeve të depistimit sjell vështirësi të ndryshme etike, ligjore, sociale, mjekësore, organizative dhe ekonomike. Efektet optimale të programeve në popullatë me burimet financiare të përdorura për atë qëllim mund të arrihen vetëm nëpërmjet zbatimit me rigorozitet të programeve. Vlerësimi i vazhdueshëm i programit dhe ndërhyrja me përmirësimë të reja janë një kontribut i rëndësishëm përritjen e produktivitetit.

Në vitet e ardhshme, ISHP do të fuqizohet – me anë të disa programeve depistuese dhe parandaluese kombëtare – dhe do të zhvillojë modele të reja survejimi me qëllim vlerësimin e objektivave të arritur dhe bërjen e përmirësimeve.

Qëllimi strategjik 3: Deri në vitin 2023, ISHP do të përmirësojë dhe perfektionojë mbledhjen e të dhënavës dhe informacionit mbi funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë informacionin kyç shëndetësor dhe ekonomik, si dhe informacionin në lidhje me cilësinë e kujdesit shëndetësor.

Strategjia 3.1. Analizimi i të dhënavës të kujdesit shëndetësor përritje/ vepruar me efikasitet:

- Analiza periodike e të dhënavës të kujdesit shëndetësor përritje;
- Analiza periodike e kërkuesës përritje shërbimeve të kujdesit shëndetësor;
- Analiza periodike e zbatimit të kujdesit shëndetësor parandalues;
- Zhvillimi i modeleve dhe tendencave të nevojave përritje kujdesit shëndetësor duke marrë në konsideratë ndryshimet strukturore të popullsisë dhe situatën shëndetësore;
- Përdorimin e qasjeve të reja analitike përritje përcaktuar prioritetet shëndetësore.

Strategjia 3.2. Përgatitja e informacionit të kërkuar përritje organizimin e aktiviteteve të kujdesit shëndetësor:

- Përgatitja e informacionit të kërkuar përritje përcaktimin e rrjetit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor;
- Përgatitja e informacionit të kërkuar përritje përcaktimin e detyrave sipas shërbimeve dhe niveleve;
- Raportim i detajuar mbi funksionimin e sistemit shëndetësor në periudha 3-5 vjeçare, i cili do të përfshijë karakteristika kyç të sistemit, si dhe tendencat përritje 10-15 vitet në vazhdim. Gjithashtu, do të përfshijë një vlerësim të efektit të masave dhe ndërhyrjeve të bëra, si dhe një parashikim përritje tendencat e ardhshme;
- Përgatitja e rekomandimeve përritje një funksionim eficient ose të përmirësuar të sistemit të kujdesit shëndetësor.

Qëllimi strategjik 4: Deri në vitin 2023, ISHP do të konceptojë një rrjet vlerësimi të plotë të teknologjisë shëndetësore (HTA) në Shqipëri.

Strategjia 4.1. Krijimi i një rrjeti për vlerësimin e teknologjisë shëndetësore (HTA):

Identifikimi i organizatave dhe ekspertëve të ndryshëm për rrjetin HTA;

- Krijimi zyrtar i rrjetit të HTA me koordinatorë;
- ISHP- Përgatitja e draftit të planit të veprimeve.

Strategjia 4.2. Vlerësimi i teknologjisë shëndetësore:

- Përgatitja e planeve vjetore të zbatimit duke patur parasysh priorititet kombëtarë;
- Përgatitja e një plani të detajuar duke u mbështetur mbi planet vjetore.

Qëllimi strategjik 5: Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë zhvilluar një model të integruar për parandalimin dhe kujdesin tërësor të sëmundjeve kronike, dhe do të marrë rolin drejtues në kujdesin shëndetësor parandalues në të gjitha fushat.

Strategjia 5.1. Zhvillimi dhe krijimi i një modeli të integruar për parandalimin dhe kujdesin e plotë të sëmundjeve kronike:

- Përgatitja e analizës së organizimit aktual, kapaciteteve njerëzore, burimeve financiare dhe metodave të financimit;
- Hartimi i udhëzimeve nga ekspertët, algoritmet dhe masat përmarrjen e vendimeve në lidhje me trajtimin e individëve në rrezik dhe ata që tashmë vuajnë nga sëmundjet kronike kryesore, si dhe treguesit e performancës në fushën e parandalimit dhe trajtimit të plotë të sëmundjeve kronike.

Strategjia 5.2. Ngritja dhe përforcimi i koordinimit të programeve parandaluese dhe të depistimit në nivel kombëtar:

- Përgatitja e një protokolli për depistimin e popullatës dhe programeve të parandalimit;
- Ngritja dhe forcimi gradual i koordinimit në nivel kombëtar (menaxhimit kombëtar¹) të të gjitha programeve parandaluese dhe depistuese²;
- Ngritjen e një rrjeti, përfshirë koordinatorët kombëtarë dhe rajonalë, si dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor parandalues.

¹ Menaxhimi kombëtar përfshin hartimin e programit, trajnimin e ofruesve, promovimin, monitorimin e zbatimit, monitorimin e treguesve (indikatorëve) të performancës, monitorimin e përfundimeve dhe efektivitetin e programit, duke propozuar përmirësimë të mëtejshme.

² Kjo nuk zbatohet për programet ku koordinimi kombëtar sigurohet në mënyrë të suksesshme nga një institucion tjeter i kujdesit terciar.

KËRCËNIMET SERIOZE PËR SHËNDETIN DHE MBROJTJA E SHËNDETIT

Roli i ISHP-së për të siguruar këtë funksion kyç të shëndetit publik, është identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut (riskut), me qëllim marrjen e masave në kohën e duhur për **sigurimin dhe mbrojtjen e shëndetit, përgatitjen në mënyrë adekuate për ngjarjet të cilat mund të ndodhin në spektër të gjerë ose në mënyrë të papritur dhe që përbëjnë kërcënim serioz për shëndetin**. Planifikimi, studimi dhe përgjigjja ndaj këtyre kërcënimeve të papritura (të mundshme) mbi shëndetin, kërkon aftesinë për t'i vlerësuar ato, për të përgatitur protokollët mbi marrjen e masave, si dhe kontolle të rregullta, nëse zgjidhjet individuale korrespondojnë me rr Ethanat e ndryshuara.

ISHP do të ngrëjë një **ekip kombëtar për hetimin e shpërthimeve epidemike** të sëmundjeve dhe rr Ethanave kur organizimi i kërkimeve në nivel rajonal ose lokal mund të mos jetë i përshtatshëm, ose i mjafueshëm.

Ne do të krijojmë një **sistem aktiv epidemiologjik kërkimi** për të zbuluar në kohë ngjarje dhe kërcënime të pazakonta, duke përfshirë një laborator për monitorimin epidemiologjik. Hapa të rëndësishëm në këtë drejtim janë përfundimi i projekteve ekzistuese të zgjidhjeve moderne të informacionit dhe për të implementuar përkufizimet standarde të sëmundjeve. Përveç kësaj, me përdorimin më të mirë të teknologjisë kompjuterike dhe internetit, ne do të trisim ndjeshmérinë e informimit dhe të sistemit të vëzhgimit.

Ne do të forcojmë bashkëpunimin me ekspertët për sëmundjet ngjitëse në nivel rajonal në mënyrë që trajtimi i epidemive të jetë i standardizuar, sa më shumë të jetë e mundur. Duke përdorur metoda moderne dhe një qasje ndërdisiplinore, ne do të njohim rreziqet e shëndetit publik që rrjedhin nga sëmundjet e reja dhe në zhvillim, si dhe të përcaktojmë programe të tjera prioritare për parandalimin e sëmundjeve të cilat do të janë të bazuara në fakte (evidencë).

Meqenëse e kuptojmë që **m jedisi dhe fusha e shëndetit** është aq komplekse saqë institucione të veçanta nuk arrijnë ta mbulojnë atë në mënyrë gjithëpërfshirëse, ne do të përqendrohemë në krijimin e rrjeteve dhe bashkimin e ekspertëve nga institucione të ndryshme për të dhënë një pasqyrë të plotë dhe komplekse të faktorëve mjedorë që ndikojnë drejtpërdrejt në shëndet në rajonin tonë, si dhe për të kontribuar për hartimin e programeve për mbrojtjen e tij. Bashkëpunimi në disa projekte Evropiane krijon themellet për të ndërtuar metodologjinë për njojen e rreziqeve të lartpërmendura mjedisore, për t'u pajisur me mjetet për të vlerësuar ekspozimin dhe për të krijuar një sistem informimi/njoftimi të publikut.

ISHP do të krijojë bashkëpunim të ngushtë me të gjitha laboratorët në Shqipëri nga ku mund të identifikohen agjentët (shkaktarët) e sëmundjeve ngjitëse, si dhe përgatitjen e protokolleve për shkëmbimin e informacionit dhe për bashkëpunimin e fytshëm. Në raste të veçanta, ISHP do të ofrojë kapacitete laboratorike në zonat ku nuk ka asnjë të tillë në Shqipëri, por që janë me rëndësi të madhe për shëndetin publik.

Imunizimi (vaksinimi) mbetet një nga masat më efikase për parandalimin esëmundjeve ngjitëse. ISHP ka për detyrë përgatitjen e programeve të imunizimit (vaksinimit) për grupet e synuara të popullatës, duke bërë të mundur mbështetjen profesionale në dispozicion të

ofruesve në paraqitjen dhe zbatimin e programeve të reja të imunizimit (vaksinimit) që sigurojnë mbrojtjen optimale kundër sëmundjeve të parandalueshme nga vaksinat.

Përgatitja e një programi vjetor për mbrojtjen e populatës me anë të imunizimit (vaksinimit) do të mbetet një nga prioritetet kryesore. Përgatitja e një programi imunizimi (vaksinimi) dhe futja e risive janë çështje të cilat shpesh janë objekt i gjykimit dhe kritikave publike. Aktualisht, institucionet kryesore dhe organet zbatuese (Bordi Kombëtar i Ekspertëve) janë të përfshira në procesin e vendimmarjes. Për të përgatitur programet e vaksinimit dhe në veçanti për të futur vaksina të reja, do të jetë e nevojshme më shumë ekspertizë (sa më shpejt të jetë e mundur), ndërsa gjithashtu, është një nevojë për të përcaktuar kriteret dhe siguruar mbështetje në vendimmarje. ISHP ka përcaktuar tashmë nevojat në lidhje me krijimin e një grapi ekspertësh për imunizim (vaksinimin), ku anëtarët do të jenë ekspertë nga fusha të cilët do të ndihmojnë në përgatitjen e programit. Hartimi i programit në këtë mënyrë do të plotësohet nga një shqyrtim i propozimeve nga një grup ndërdisiplinor të cilët do të përcaktohen nga Ministria e Shëndetësisë apo ISHP.

Furnizimi i besueshëm me vaksina është i një rëndësie të madhe për programet e imunizimit (vaksinimit). Shqipëria ka një sistem të centralizuar të prokurimit dhe të shpërndarjes së vaksinave, të kryer nga ISHP, si pjesë e aktiviteteve të saj të shërbimit publik. Nëse sistemi i prokurimit është akoma i pamodifikuar dhe mbetet përgjegjësi i ISHP-së, është i nevojshëm financimi publik transparent dhe i qëndrueshëm, duke siguruar furnizimin me vaksina pavarësisht nga çmimet e luhatshme. Detyra e ISHP-së do të jetë për të siguruar vaksina me çmimin më të favorshëm për blerësin.

Qëllimi strategjik 6: Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë forcuar rolin e vet si pikë kryesore e informacionit për vlerësimin e rrezikut (riskut) dhe reduktimin e sëmundjeve ngjitëse, duke siguruar mbështetje me ekspertë në hartimin dhe zbatimin e masave të nevojshme.

Strategji 6.1. Vlerësimi i rreziqeve (risqeve) ndaj shëndetit nga sëmundjet ngjitëse apo infeksione bazuar në informacione të besueshme:

- Ruajta dhe zhvillimi i një sistemi për monitorimin epidemiologjik të sëmundjeve ngjitëse, duke përfshirë zhvillimin e metodave dhe modeleve të reja, si dhe ngritjen e komunikimit epidemiologjik;
- Krijimi i monitorimit laboratorik epidemiologjik për agjentë të veçantë;
- Realizimi dhe analizimi periodik i të dhënave mbi sëmundjet ngjitëse;
- Përfshirja e qasjeve të reja analitike për njojen e zonave prioritare që kërkojnë ndërhyrje, pa përjashtuar njojen dhe analizën e determinantëve, si dhe vlerësimin e barrës së sëmundjeve të veçanta;
- Zhvillimi i modeleve dhe tendencave parashikuese për sëmundje ngjitëse të veçanta.

Strategji 6.2. Hartimi dhe zhvillimi i një programi për parandalimin dhe reduktimin e sëmundjeve ngjitëse:

- Përditësimi periodik i programit kombëtar të imunizimit;
- Përgatitja e programeve depistuese për sëmundje ngjitëse të veçanta;
- Përgatitja dhe zbatimi i një programi të plotë të menaxhimit të sëmundjeve ngjitëse.

Qëllimi strategjik 7: Deri në vitin 2022, ISHP do të ketë ngritur një sistem për monitorimin e sëmundjeve të lidhura me mjedisin dhe faktorët mjedorë që ndikojnë në shëndet, si dhe do të sigurojë informacione kyç për mjedisin dhe shëndetin.

Strategjia 7.1. Ngritura e indikatorëve kyç dhe kryerja e kërkimeve epidemiologjike:

- Zhvillimi i një strategjie afatgjatë për monitorimin e indikatorëve;
- Planifikimi dhe kryerja e studimeve epidemiologjike;
- Përgatitja e informacionit mbi mjedisin dhe shëndetin;
- Raporte vjetore mbi mjedisin dhe shëndetin.

Qëllimi strategjik 8: Deri në vitin 2023, ISHP do të jetë pika kryesore e referencës për koordinimin e përgjigjeve të shpejta ndaj kërcënimeve të shëndetit për shkak të shfaqjes së sëmundjeve ngjitetë, përhapjen e qëllimshme të agjentëve biologjikë, apo shfaqjen e sëmundjeve me origjinë të panjohur.

Strategjia 8.1. Forcimi i zbulimit të hershëm dhe i sistemit ndërhyrjes (reagimit):

- Zhvillimi i metodave dhe modeleve të reja për të monitoruar shfaqjen e kërcënimeve të papritura të shëndetit, duke përfshirë ngritjen e komunikimit epidemiologjik;
- Krijimi i monitorimit epidemiologjik laboratorik për agjentë të cilët mund të paraqesin rrezik për shëndetin;
- Plotësimi dhe zgjerimi i planeve të veprimit;
- Monitorimi i zbulimit të hershëm dhe i sistemit të ndërhyrjes (reagimit).

Strategjia 8.2. Krijimi i një ekipi të shpejtë ndërhyrjeje: - Ngritura e një ekipi për hetime epidemiologjike.³

- Trajnimi i ekipit për të punuar në kushte krize;
- Ngritura e një rrjeti laboratorik për të identifikuar shkaktarët;
- Ngritura e njësisë së menaxhimit të krizave.

SHËRBIMI KOMBËTAR I INFORMACIONIT SHËNDETËSOR

Shëndetësia elektronike (shërbimet e informacionit shëndetësor; shërbimet elektronike të bazuara në teknologjitet e informacionit dhe komunikimit në kujdesin shëndetësor dhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor) është identifikuar si një fushë strategjike globale e cila do të çojë në zhvillimin e mëtejshëm, përmirësim të nivelit të suksesit dhe efektivitetin e kostos të sistemeve shëndetësore në dekadën e ardhshme. E njëjtë gjë vlen edhe për kujdesin shëndetësor publik, ku teknologja dhe shërbimet do të bëjnë të mundur përditësimin më të mirë të dhënavë, mbledhjen dhe automatizim të përpunimit të tyre, komunikim të thjeshtë dhe më të shpejtë, si dhe një sërë tiparesh të reja në kujdesin shëndetësor publik që nuk arritën të implementohen në të shkuarën⁴. ISHP e konsideron modernizimin e nivelit të infrastrukturës së informacionit në qendrat e kujdesit shëndetësor publik, si një nga priorititetet e saj.

**Plani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për
periudhën 2021-2023**

³ Ekipi do të marrë përsipër detyrën e hetimeve epidemiologjike për shpërthime të mëdha epidemike (ato që shtrihen përtjerë territorit të një rajoni) ose epidemive të shkaktuara nga agjentë të rrallë, kur nuk ka përvojë të mjaftueshme sigurohet në nivel rajonal.

⁴p.sh., rrjeti i personalizuar brenda kujdesit shëndetësor publik; ndjekja e epidemisë, identifikimi dhe parashikimi i shpejtë; zbulimin e lidhjeve të reja të dhënavës në kujdesin shëndetësor publik duke përdorur të dhëna të duhura; shfrytëzimi i rrjeteve sociale aktuale për të formuar metodat e reja të ndërhyrjes në kujdesin shëndetësor publik, shkëmbimin e informacionit etj.

Në vitet e ardhshme, ISHP do të kërkojë mjete moderne të informacionit dhe komunikimit për të arritur qëllimet e përcaktuara në të gjitha fushat strategjike prioritare. Infrastruktura e informacionit nuk ka tërhequr vëmendjen e duhur në vitet e mëparshme dhe shumica e projekteve të zhvillimit nuk janë bërë pjesë e një strategje të unifikuar; pra, strukturat e informacionit të ISHP-së mbeten të fragmentuara, qendra e saj e informacionit e dobët, stafi i mbingarkuar dhe njohuritë dhe aftësitë e aplikacioneve moderne të pamjaftueshme në të gjithë organizatën. Për të përmirësuar gjendjen e tanishme, në mënyrë sistematike do të rinojshmë infrastrukturën e brendshme të informacionit, modernizimin e proceseve të punës, instalimin e mjeteve për të dhënat elektronike dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet ISHP-së dhe korrespondentëve, si dhe rritjen e nivelit të njohurive dhe aftësive në mjetet moderne të informatikës në të gjithë organizatën.

Për shkak të ndryshimeve bashkëkohore në lidhje me shëndetësinë elektronike ose shërbimet e informacionit shëndetësor, ISHP e ka shtuar shëndetësinë elektronike tek prioritetet e saj strategjike (Ministria e Shëndetësisë inicioi projektin e shëndetësisë elektronike 2009-2019. Ka patur rritje të kërkesës për kompetencat dhe kapacitetet në fushën e shëndetësisë elektronike në ISHP dhe gjérësish në sistem). Brenda të gjithë mundësive të saj, ISHP do të mbështesë vazhdimin e projektit kombëtar të shëndetësisë elektronike dhe do të përshtasë projektet e veta të zhvillimit në drejtim të arritjes së sinergjisë maksimale me këtë projekt. Për këtë qëllim, ISHP do të vazhdojë me zhvillimin e planifikuar afatgjatë të kompetencave, kapaciteteve dhe të detyrave të ndërmarra në projektin e shëndetësisë elektronike (p.sh., Qendra e Informacionit të Kujdesit Shëndetësor). Për të arritur këtë qëllim, duhet të zgjerohen burimet njerëzore në dispozicion (pjessërisht nga rigrupimi i brendshëm, por kryesisht duke zgjeruar personelin) dhe burime të reja të rekrutuara, sidomos nga projekti i shëndetësisë elektronike.

Në vitet e ardhshme, ne do të adresojmë nevojat tona të brendshme dhe të jashtme, dhe për këtë arsyë të unifikojmë një metodologji për krijimin dhe menaxhimin e sistemit të të dhënavë. Ne do të rinojshmë mbledhjen e të dhënavë, përpunimin dhe mbajtjen, e cila përfshin krijimin e një qendre të vetme informacioni statistikor të kujdesit shëndetësor, rinvimin dhe unifikimin e mbledhjes së të dhënavë nga ana e ofruesve të informacionit duke futur funksionimin elektronik B-B (biznes-biznes) për të gjitha format e raportimit. Ne do të krijojmë politika moderne të sigurisë, si dhe ndjekjen e aksesit dhe përdorimin e të dhënavë; do të rrisim disponueshmërinë e të dhënavë në sistemet e të dhënavë (për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm - ofruesit e informacionit, publikut dhe palëve të tjera). Gjithashtu, do të regjistrojmë, modernizojmë dhe mbështesim nga ana teknologjike proceset operacionale; do të krijojmë një **Qendër Kombëtare për të Dhënat Shëndetësore** dhe një zyrë të projektit për të mbështetur rritjen e mëtejshme në fushën e projektit.

Ne jemi të vetëdijshëm se, për shkak të orientimit strategjik, do të duhet të fuqizojmë në mënyrë të konsiderueshme anën tonë të brendshme dhe të jashtme financiare, si dhe kontributin njerëzor, duke përfshirë edhe marrjen e aftësive shtesë⁵. Ky kusht, sidqoqoftë, është edhe celësi i suksesit.

Aktivitetet afatshkurtra do të përfshijnë fillimin e projekteve që mbështesin një strategji afatgjatë dhe vazhdimin e projekteve të shëndetësisë elektronike të filluara tashmë (projekti për recetën elektronike, përmirësimi i ndjekjes vaksinale etj.). Aktivitetet afatmesme do të përqendrohen kryesisht në zgjerimin e burimeve që janë në dispozicion (njerëzore dhe financiare), si dhe fillimin e projekteve të rëndësishme (Qendra Kombëtare për të Dhënat Shëndetësore, proceset e brendshme, marrdhëniet mes palëve – BB, trajnime të brendshme).

Një nga aktivitetet më të rëndësishme të kujdesit shëndetësor publik është sigurimi i të dhënavë mbi shëndetin, përcaktorët e shëndetit dhe sistemin e kujdesit shëndetësor. Të dhënat dhe

Plani i Zhvillimit Strategik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2021-2023

informacionet e bazuara tek ato, janë vendimtare për përcaktimin e niveleve shëndetësore të popullatës.

Aktualisht ISHP mbledh dhe analizon të dhëna për Sëmundjet jo- të Transmetueshme përmes regjistrat të Kancerit, Regjistrave për Sëmundjet Ishemike të Trurit dhe të Zemrës, Regjistrat të Diabetit, Regjistrat të Defekteve të Lindura, Regjistrat të Aborteve, dhe Sistemit të Shpërndarjes së Metodave Moderne Kontraceptiveve (LMIS).

Në mënyrë që problemet të menaxhohen si një e tërë, ISHP bashkëpunon me institucione të tjera (NJVKSH-të, OSHKSH, ISHSH) të cilat janë Strukturat Shëndetësore në nivel Kombëtar, në nivel Rajonal dhe në nivel Lokal) që merren me menaxhimin e të dhënavë të ngjashme; si Regjistrin e Kancerit, Institutin e Sigurimeve Shëndetësore të Shqipërisë, klinikat të cilat menaxhojnë regjistra dhe njësitë rajonale të sigurimeve shëndetësore.

Bashkëpunimi ndërsекторial për mirëfunkcionimin e Regjistrave realizohet përmes takimeve dhe një bashkëpunimi të ngushtë me MSHMS, spitalet Universitare, rajonale dhe të rrtheve, NJVSHK, OSHKSH dhe qendrat shëndetësore për harmonizimin e instrumentave dhe shkëmbimin e informacionit. Për përmirësimin dhe verifimin e informacionit lidhur me sëmundjet jo të transmetueshme, Institutit i Shëndetit Publik bashkëpunon ngushtësisht me spitalet e vendit, Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Parësor dhe INSTAT.

ISHP ruan/magazinon të dhënat e kujdesit shëndetësor dhe mbrojtjes së shëndetit; këto të dhëna të mbledhura përpunohen dhe paraqiten në një mënyrë të lehtë përdorimi. Standardet dhe treguesit e siguruar do të përcaktohen në mënyrë të qartë gjatë procesit të modernizimit të bazave kombëtare të të dhënavë. Standardet dhe treguesit do të janë të ndërlidhura për të siguruar tregues të tjerë. Kërkesat për mbledhjen e të dhënavë do të reduktohen duke përfshirë të dhënat e menaxhuara nga administratorët e tjerë, rrjedhimisht dhe detyrat administrative të raportueseve do të reduktohen. Feedback-u i garantuar që raportuesit e informacionit do të marrin me pas, do të ndikojë në cilësinë e raportimeve të tyre të mëtejshme.

Vendimtare për lidhjen e të dhënavë janë përkufizimet dhe lista e kodeve. Për sa i përket statistikave shëndetësore, ISHP do t'i japë prioritet përpjekjeve të saj për të vendosur përkufizime të unikuara të fjalëve kyçe dhe kategorive të përdorura në monitorimin e sistemit të kujdesit shëndetësor dhe niveleve shëndetësore të popullatës.

Raportet 2-vjeçare të përgatitura me të dhënat shëndetësore, demografike, social- ekonomike në shkallë vendi, sigurojnë një bashkëpunim efektiv për grumbullimin dhe sidomos vlerësimin e cilësisë së të dhënavë në interes të ISHP-së, ndërmjet institucioneve INSTAT, QSUT, FDSKSH [ish ISKSH], etj.

ISHP do të zhvillojë kapacitetet e saj për të mundësuar instrumente të tjera përmarrjen e të dhënavë, kryesisht nga pyetësorët. Ata janë të rëndësishëm në mbledhjen e sa më shumë të dhënavë cilësore mbi gjendjen e shëndetit të popullatës dhe të nivelit të kënaqësisë në lidhje me kujdesin shëndetësor.

ISHP do të menaxhojë databazat administrative të cilat do të shërbejnë në nivel kombëtar si një mbështetje për planifikimin e sistemit të kujdesit shëndetësor dhe marrjen e hapave drejt përmirësimit të shëndetit të popullatës apo mbrojtjes së shëndetit.

⁵ Aftësitë në menaxhimin e kontraktorëve (në fushën e informacionit të komisioneve të shërbimeve), aftësi në planifikimin financiar (për të marrë vendime strategjike në lidhje me investimet në infrastrukturën e informacionit).

Qëllimi strategjik 9: Deri në vitin 2023 ISHP do të krijojë një qendër kombëtare informacioni shëndetësor për të menaxhuar databazat kombëtare të kujdesit shëndetësor, të sigurojë të dhëna dhe informacione me qëllim gjenerimin e raporteve ndërkombëtare, si dhe planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor në një mënyrë të lehtë dhe të zbatueshme.

Strategjia 9.1. Vodosja e standardeve të unifikuara, klasifikimeve dhe fjalorëve në fushën e kujdesit shëndetësor:

- Përdorimi i klasifikimeve dhe listës së kodeve ndërkombëtare për databazet;
- Përshtatja e databazave ekzistuese në klasifikimet e reja;
- Përfshirja e terminologjisë dhe fjalorëve në databaza;
- Krijimi i një ekipi të qëndrueshëm për klasifikimet dhe standartet.

Strategjia 9.2. Krijimi i zgjidhjeve shëndetësore moderne për popullatën dhe ofruesit:

- Ndërtimi i një regjistri vaksinimi elektronik;
- Ndërtimi i një shërbimi elektronik për parandalimin dhe vaksinimin.

Strategjia 9.3. Mbledhja rutinë dhe e përqendruar e të dhënavë duke reduktuar ngarkesën e ofrueseve të informacionit:

- Mbledhja e të dhënavë nga databazat e tjera administrative;
- Scooping automatik i të dhënavë;
- Modernizimi dhe unifikimi i databazave që përdoren për raportime.

Strategjia 9.4. Sigurimi i të dhënavë cilësore dhe të zbatueshme:

- Përmirësimi i vazdueshëm i cilësisë së të dhënavë dhe njëkohësisht paraqitja cilësore e raporeve;
- Paraqitja e databazave;
- Paraqitja e metadatave;
- Paraqitja e të dhënavë për raportime ndërkombëtare.

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Institucioni ynë ka si qëllim përmirësimin e shëndetit publik, kështu që besoni në të dhënat që ne ofrojmë dhe rekomandimet tona pasi janë me shumë rëndësi. Ne jemi të vetëdijshëm se ndërtimi i besimit është i lidhur fort me komunikimin e qartë dhe efikas me publikun dhe dialogun me partnerët.

ISHP do të reagojë në kohë për të përbushur nevojat e individëve, të profesionistëve dhe vendimmarrësve bazuar në të dhëna dhe informacionet përkatëse. Ne do të vazhdojmë të kërkojmë mënyra të ndryshme për të na sjellë afér me audiencën e synuar, me theks të veçantë në zhvillimin e teknologjive dhe zgjerimin e rrjetit. Të dhënat dhe informacionet që ne ofrojmë do të janë të rëndësishme, të përditësuara, të kuptueshme, të verifikuara, të shpejta, të qarta dhe transparente. Kur të jetë e nevojshme ne do të konsultohemi me institucione të tjera të

rëndësishme brenda dhe jashtë vendit, për të siguruar shkëmbimin e informacionit dhe përputhjen e tij në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet forcimit të komunikimit proaktiv.

Ne do të vazhdojmë të monitorojmë dhe përmirësojmë njojuritë tona mbi nevojat e publikut përmarrjen e informacionit lidhur me mbrojtjen e shëndetit; do të forcojmë transparencën dhe sinqueritetin e punës tonë; do të përpinqemi të inkurajojmë iniciativa të mëtejshme për të kapërcyer boshllékun midis shkencës dhe nevojave të popullatës.

Në të njëjtën kohë, ne do të përmirësojmë komunikimin e brendshëm dhe do të zgjerojmë kanalet komunikuese të rrjetit (edhe me ndihmën e teknologjive të reja) në mënyrë që të sigurohet më mirë lidhja horizontale dhe vertikale e punonjësve dhe përhapja e ideve, njojurive dhe eksperiencave brenda institutit.

Qëllimi strategjik 10: Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë forcuar rolin e vet si qendra kryesore e informacionit për shëndetin publik e cila siguron që individët, profesionistët e shëndetit dhe vendimmarrësit janë të pajisur me informacion të paanshëm nëpërmjet komunikimit proaktiv, të përditësuar dhe transparent.

Strategjia 10.1. Komunikim efikas me komunitetin e profesionistëve:

- Pjesëmarrja aktive e profesionistëve te ISHP-së në të gjitha konferencat përkatëse profesionale brenda dhe jashtë vendit;
- Publikimi i artikujve shkencorë dhe profesionalë;
- Krijimi i një faqeje të veçantë online dedikuar komunitetit të profesionistëve e rifreskuar me informacionet më të fundit;
- Kërkimi dhe përdorimi i mënyrave të reja të komunikimit me komunitetin e profesionistëve.

Strategjia 10.2. Komunikim efikas dhe i koordinuar i informacionit kyç të shëndetit publik me mediat dhe publikun e gjerë:

- Krijimi i një qendre informacioni në ISHP dhe dhënia e mesazhave standarde;
- Monitorimi i mbulesës mediatiche dhe përgjigjes sonë të menjëhershme;
- Krijimi i një faqeje online me informacionet dhe materialet më të fundit; Identifikimi i target- grupeve dhe nevojave te tyre;
- Bashkëpunimi për hartimin e informacionit dhe materialeve të ISHP-së që kanë interes për median dhe publikun e gjerë;
- Shpërndarja e informacionit në mënyrë të qartë dhe interesante;
- Futja e mjeteve moderne dhe kanaleve të komunikimit;
- Workshop-e edukuese dhe trajnime për profesionistët e shëndetit publik të cilët nuk kanë njojuri në lidhje me komunikimin me median dhe publikun e gjerë.

Strategjia 10.3. Koordinimi dhe asistenca e ofruar nga zëdhënësit e shëndetit publik në Shqipëri:- takime periodike me zëdhënësit e organizatave të tjera të shëndetit publik dhe promovuesit e shëndetit; - takime periodike me shtypin që mbulon aspekte të shëndetit publik; - workshop-e dhe trajnime informuese me partnerët tanë.

Strategjia 10.4. Përfshirja e zëdhënësve/punonjësve të mirëkualifikuar (IVZ) në projektet dhe shoqatat ndërkombe të shëndetit publik: - pjesëmarrja aktive e këtyre punonjësve (IVZ) në rrjetin e gjerë të komunikimit midis tyre.

KUALIFIKIMI I PROFESIONISTËVE TË SHËNDETIT PUBLIK

Profesionistët e shëndetit publik në Shqipëri, përvèç ISHP-së, bashkëpunojnë dhe me organizata të tjera shëndetësore, të tillë si drejtoretë rjonale të shëndetit publik, QSUT "Nënë Tereza", etj. Një rol më i madh i profesionistëve të shëndetit publik në të gjitha programet edukuese të shëndetit publik dhe shoqatave të tjera do të ndihmojë ISHP –në, në zhvillimin dhe forcimin e fushave të ndryshme të shëndetit publik.

Edukimi i profesionistëve të shëndetit publik ofrohet nëpërmjet programeve parauniversitare dhe kurseve pasuniversitare, si dhe trajnimeve në Shqipëri dhe jashtë vendit.

ISHP do të kontribuojë në zhvillimin e karrierës së profesionistëve të shëndetit publik duke organizuar trajnime të ndryshme, në grupe (leksione, seminare) ose individualisht (seminare, detyra apo projekte). Nëpërmjet kësaj, ne do të ndihmojmë në forcimin dhe zhvillimin e njojurive ekzistuese dhe fitimin e njojurive të reja - me transferimin e njojurive në Shqipëri dhe jashtë vendit.

ISHP do të theksojë zhvillimin dhe kualifikimin e trajnerëve, sidomos të trajnerëve nga drejtoretë rjonale të shëndetit publik. Profesionistët me njojuri të thella dhe të gjera janë një parakusht për të patur sukses në fushën e shëndetit publik. Fitimi i aftësive dhe njojurive është një proces i gjatë dhe kompleks i cili nuk përfundon me një diplomë universiteti; - ajo është të mësuarit gjatë gjithë jetës.

ISHP do të mundësojë kualifikimin profesional duke i kushtuar vëmendje të veçantë arsimimit të atyre individive të cilët më pas do të vazhdojnë të edukojnë grupet e synuara dhe kështu do të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shëndetit publik.

Qëllimi strategjik 11: Deri në vitin 2023, ISHP do të jetë një ofrues qendror trajnimi dhe edukimi në vazhdim në shëndetin publik, dhe një partner i rëndësishëm në arsimin parauniversitar dhe pasuniversitar të profesionistëve të shëndetit publik.

Strategjia 11.1. Lidhja me fakultetet dhe forcimi i kapaciteteve të mësimdhënies:

- Bashkëpunimi me fakultetet, sidomos me Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë në nivel të studimeve parauniversitare, në kuadër të specializimeve të shëndetit publik dhe studimeve të doktoraturës; Inkurajimi i profesionistëve për të kontribuar në trajnim;
- Sigurimi i kushteve për të fituar titullin e lektorit në fakultet;
- Sigurimi i punësimit me kohë të pjesshme në fakulet.

Strategjia 11.2. Hartimi i programeve të trajnimit për profesionistët e shëndetit publik:

- Trajnim i konstant i profesionistëve të shëndetit publik që do të sigurojë standardizimin e proceseve dhe procedurave në sistemin e shëndetit publik; - Zbatim i programeve të shkurtra edukative për trajnerët e programit të promovimit të shëndetit;
- Trajnim i mbi sëmundjet kronike (depistimi, regjistra, parandalim, promovim shëndeti, monitorim etj.), për strukturat/pikat e kontaktit të sëmundjeve kronike në nivel NJVKSH, OSHKSH rajonal dhe qendror.

KËRKIMI SHKENCOR NË SHËNDET PUBLIK

Kërkimi shkencor është një nga funksionet themelore të shëndetit publik. Ai mundëson eksplorimin e situatave reale dhe na bën të kërkojmë zgjidhje të reja për problemet e shëndetit publik. Në ISHP, kjo realizohet në qendrat e kujdesit terciar, si projekte hulumtuese të planifikuara, projekte kërkimore të aplikuara dhe projekte ndërkombëtare. Kërkuesit shkencorë të ISHP-së përbëjnë një grup me shumë anëtarë, e cila është e pazakontë në fushën e kërkimit shkencor. Për të siguruar cilësi të lartë, ISHP do të hartojë kriteret e veta të avancimit për grupin kërkimor.

Kërkimi shkencor do të mbetet një nga shtyllat kryesore të aktiviteteve të ISHP-së në të ardhmen. Instituti do të zhvillojë projektet e veta dhe do të angazhohet në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, që synojnë zhvillimin shkencor dhe profesional, fitimin dhe aplikimin e njohurive të reja, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe bashkëpunimin me institucionet e ngjashme partnere. ISHP do të rrisë rolin e vet qendror kërkimor në shëndetin publik, aktivitetet koordinuese dhe hulumtimin ndërdisiplinor. Prioritet do të kenë projektet kërkimore të cilat rrisin cilësinë e produktit.

ISHP do të marrë pjesë në projektet kërkimore ndërkombëtare, sidomos në programet në kuadër të integrimit në BE. Instituti do të ruajë pozicionin e tij aktual si lider në fushën e kërkimit në shëndetin publik në Shqipëri.

Qëllimi strategjik 12: Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë rritur kontributin për shëndetin publik nëpërmjet vëllimit më të madh dhe suksesit të aktiviteteve të veta të kërkimit shkencor.

Strategjia 12.1. Inkurajimi i kërkimit Shkencor; Rritja e burimeve:

- Inkurajimi i fitimit të sa më shumë tituje kërkimore që të jetë e mundur;
- Zhvillimi i infrastrukturës kërkimore shkencore të ISHP-së.

Strategjia 12.2. Inkurajimi i kërkimit shkencor:

- Pjesëmarrja në projekte kërkimore, si pjesë e procesit të rregullt të punës;
- Planifikimi i publikimeve shkencore si pjesë e procesit të rregullt të punës.

Strategjia 12.3. Inkurajimi i gazetarisë shkencore vendase, dhe sidomos mbështetje për Revistën Mjekësore (*Albanian Medical Journal*) dhe Buletinin e ISHP:

- Publikimi në *Albanian Medical Journal* të ISHP; Financimi i Revistës.

NDËRTIMI I PARTNERITETEVE

ISHP-ja është plotësisht e vetëdijshme për rëndësinë e shëndetit publik; për këtë arsyë do të bashkëpunojë jo vetëm me institucionet shëndetësore në tërësi, por edhe me institucionet nga fusha të tjera, duke ndërtuar ndërkoħe partneritete të dobishme për të gjithë.

Rrjeti, që përbëhet nga ISHP dhe drejtoritë rajonale të shëndetit publik, luan një rol vendimtar në sigurimin e shërbimeve të shëndetit publik. ISHP dhe drejtoritë rajonale mund të bashkëpunojnë kryesisht në hartimin e programeve për vlerësimin e shëndetit, projekte, mendime profesionale mbi masat e shëndetit publik, kryerjen e detyrave rutinë dhe masat për kontrollin e problemeve të shëndetit publik.

Qëllimi strategjik 13: Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë hartuar programe të strukturuara të bashkëpunimit me partnerët kyç në formën e partneriteteve me vlerë të shtuar për të gjithë.

Strategjia13.1. Ndërtimi i bashkëpunimit të strukturuar me drejtoritë rajonale të operatorit shëndetësor dhe partnerë të tjerë:

- Përcaktimi i parimeve, proceseve dhe planifikimi i përbashkët i programeve;
- Hartimi i programeve të përbashkëta;
- Krijimi i lidhjeve dhe programeve dypalëshe, kurdo që është e nevojshme;
- Vlerësim i kapaciteve infrastrukturore dhe i burimeve njerëzore në shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor;
- Vlerësim i kapaciteteve dhe nevojave lidhur me funksionet e shëndetit publik pranë Njësive Vendore të Kujdesit Shëndetësor.

Strategjia13.2. Ndërtimi i bashkëpunimit të strukturuar me Fondin e Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor të Shqipërisë dhe partnerë të tjerë të cilët do të akomodojnë platformën teknologjike për informatizimin në sistemin shëndetësor:

- Përcaktimi i parimeve, proceseve dhe planifikimin e përbashkët të programeve;
- Planifikimi i përbashkët i projekteve shëndetësore elektronike.

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Disa aktivitete të shëndetit publik, të tilla si menaxhimi i reziqeve shëndetësore, kërkojnë ndërlidhje të vazdueshme dhe bashkëpunim në projekte ndërkombëtare. Për disa aktivitete të tjera, sidoqoftë, bashkëpunimi ndërkombëtar është parakusht për zhvillim.

ISHP do të bashkëpunojë në mënyrë aktive me grupet e ekspertëve dhe forma të tjera me interes në Organizatën Botërore të Shëndetësisë, Institucionet e BE-së, Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare.

**Plani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për
periudhën 2021-2023**

ISHP do të marrë pjesë në projekte të shëndetit publik, veçanërisht ato të cilat rezultojnë në njojuri dhe përvoja të reja. Ne e konsiderojmë të rëndësishme bashkëpunimin me institutet kombëtare të shëndetit publik të vendeve të rajonit dhe shteteve anëtare të BE-së. Ne do të nxism shkëmbimin profesional dhe bashkëpunimin në projekte të përbashkëta.

Qëllimi strategjik 14: Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar, të jetë bërë një partner më i njojur dhe i respektuar në zhvillimin dhe projektet e kërkimit shkencor, dhe do të ketë zhvilluar kapacitetet për të drejtuar projekte ndërkombëtare.

Strategjia 14.1. Bashkëpunimi në grupet ndërkombëtare të ekspertëve:

- Përvetësimi i njojurive dhe informacioneve nga grupet e ekspertëve dhe zbatimi i tyre në sistemin tonë shëndetësor;
- Shpërndarja e informacionit për nevojat e grupeve të ekspertëve.

Strategjia 14.2. Përfshirja në projekte ndërkombëtare:

- Përfshirja aktive në programe dhe projekte në nivel rajonal dhe të BE-së;
- Ndërtimi i kapacitetave për drejtimin e projekteve.

Strategjia 14.3. Ndërlidhja me institute të ngjashme:

- Bashkëpunim konstant me IANPHI⁶;
- Shkëmbim profesional me institute të tjera kombëtare të shëndetit publik.

⁶ IANPHI:International Association of National Public Health Institutes

IV. ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI

Në mënyrë që të jemi efikas dhe të suksesshëm në kryerjen e misionit tonë, ISHP duhet të përshtasë dhe përditësojë mjedisin e vet të brendshëm. Ne shohim një mundësi për përmirësim, veçanërisht në zhvillimin e punonjësve, në përditësimin e proceseve të brendshme të biznesit të cilat ne duhet t'i mbështesim me teknologji informacioni (IT) bashkëkohore për krijimin e punës me projektet, dhe një organizatë që do të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet ekspertëve.

ZHVILLIMI/KUALIFIKIMI I PUNONJËSVE

Për të arritur qëllimet tona strategjike dhe funksionimin efektiv të ISHP-së në zonat strategjike të zhvillimit, ne kemi nevojë për punonjës të miredukuar, të mirëtrajnuar dhe të kënaqur. Në disa zona, ekspertiza e ekspertëve tanë është tashmë në një nivel të lartë, - të krahasueshëm ndërkombëtarisht. Në fusha të tjera, ne do të duhet të investojmë në arsim dhe trajnim. Ne do të mundësojmë qasjen e ekspertëve në baza të ndryshme të njojurive, si shqiptare ashtu dhe të huaja.

Në ISHP, është e domosdoshme që të krijojmë një kulturë ndërpersonale të mësimit dhe bashkëpunimit.

Ne do të përcaktojmë kompetencat e këruara për poste të caktuara të punës. Mjetet që do të përdorim për zhvillimin e burimeve njerëzore do të përfshijnë: bisedat vjetore, të cilat do të ndihmojnë menaxherin dhe bashkëpunëtorët e tij/saj të planifikojnë qëllimet dhe detyrat vjetore prioritare, si dhe arritjen e tyre. Arritja e qëllimeve të përcaktuara bashkërisht do të jetë baza për produktivitetin shpërblyes.

Për të identifikuar nevojat dhe prezantimin e përmirësimeve, ne do të masim kënaqësinë e punonjësve.

Qëllimi strategjik 15: Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë përmirësuar operacionet e veta të biznesit me punonjësit e arsimuar dhe trajnuar në mënyrë të përshtatshme dhe duke zhvilluar një mjedis stimulues pune.

Strategjia 15.1. Përshtatja e numrit dhe strukturës së të punësuarve për zbatimin e orientimeve strategjike:

- Ristrukturimi i brendshëm⁷ i punonjësve sipas prioriteteve të përzgjedhura;
- Krijimi i një sistemi të trajnimit të brendshëm;
- Forma fleksibile punësimi.

Strategjia 15.2. Sigurimi i një mjedis stimulues pune:

- Vendosja e komunikimit të mirë të brendshëm;
- Trajnim lidhur me menaxhimin;

- Krijimi i mënyrave joformale të bashkëpunimit dhe shoqërizimit.

⁷Internal restructuring means reallocating staff and training for new tasks.

PËRDITËSIMI I PROCESIT KRYESOR DHE ATYRE MBËSHTETËSE

Proceset operacionale në ISHP do të identifikoohen, analizohen dhe përkufizohen duke synuar vjeljen e qëllimeve strategjike dhe realizimin e funksionit të ISHP-së në zonat strategjike të zhvillimit nëpërmjet kuadrit të punës të organizuar në mënyrë të përshtatshme.

Organizimi i brendshëm i Institutit do të përshtatet për të mundësuar fleksibilitet dhe menaxhimin e projekteve; proceset e brendshme do të modifikohen në mënyrë që t'i vijnë në ndihmë të gjithë të punësuarve dhe përdoruesve në arrijen e qëllimeve të tyre. Këto detyra do të shfrytëzojnë përdorimin e sa më shumë operacioneve të jetë e mundur. Proseset e brendshme do të mbështeten nga një sistem i unifikuar informacioni për të mundësuar qasje të shpejtë, integrale dhe të pakomplikuar. Do të arrihet një cilësi më e mirë e shërbimeve tona dhe thjeshtëzim i punës nëpërmjet zhvillimit të zgjidhjeve të reja të informacionit për racionalismin e proceseve të biznesit.

Sistemi i informacionit i unifikuar do të rregullojë rrjedhën e mesazheve postare, si dhe regjistrimin dhe menaxhimin e dokumenteve dhe materialeve të dokumentuara. E njëjta gjë do të sigurohet edhe për financën dhe kontabilitetin, menaxhimin e projekteve, trajnimin e personelit dhe zhvillimin e kompetencave.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet sigurimit të integritetit të proceseve dhe ndërlidhjen e tyre, nga formularët e të dhënavë deri tek informacioni dhe njohuritë. Udhëzuesi i parë do të sugjerojë zbatimin e elementeve të sigurisë në sistemin e informacionit dhe përmirësimin e tyre, për të garantuar sigurinë e të dhënavë dhe informacionit personal.

Qëllimi strategjik 16: Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë rritur efikasitetin e mjedisit të biznesit nëpërmjet modernizimit të proceseve të biznesit dhe përshtatjes së tyre me infrastrukturën e informacionit.

Strategjiia 16.1. Krijimi i listës së procesit kryesor dhe atyre mbështetëse dhe përditësimi i tyre:

- Listimi i proceseve;
- Krijimi i një sistemi të unifikuar të proceseve të brendshme me ndërveprime të përcaktuara;
- Përcaktimi i treguesve për monitorimin e proceseve.

Strategjiia 16.2. Përshtatja e proceseve ndaj infrastrukturës së informacionit:

- Mjetet unifikuese të informacionit për të mbështetur përpunimin e të dhënavë;
- Modernizimi i mbështetjes së informacionit për proceset mbështetëse;
- Zbatimi i aplikacioneve moderne.

SIGURIMI I FINANCIMIT TË QËNDRUESHËM

Sasia e fondeve nuk është elementi i vetëm më i rëndësishëm i funksionimit të qëndrueshëm; kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet aftësisë së ISHP-së për të siguruar shpenzimet e duhura të fondeve të destinuara dhe të përshtatura për projektet prioritare të zhvillimit. Sidoqoftë, aktivitetet e disa viteve të ardhshme do të fokusohen në sigurimin e financimit të përshtatshëm. Financimi i pamjaftueshëm në disa fusha - nga të cilat sistemi i informacionit konsiderohet më i rëndësishmi - është një pengesë serioze për kryerjen e detyrate të planifikuara.

Siç u përmend më lart, shpenzimi i përshtatshëm i fondeve ka gjithashtu shumë rëndësi. Prandaj, ISHP do të krijojë një sistem të planifikimit dhe monitorimit të zbatimit të planeve vjetore dhe financiare. Në rastet e anomalive të pajustifikuara, masat korriguese do të mund të merren në kohë.

Qëllimi strategjik 17: Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë vendosur operacione financiare transparente dhe të qëndrueshme.

Strategjia17.1. Sistem transparent planifikimi dhe raportimi:

- Sigurimi i financimit të qëndrueshëm të aktiviteteve;
- Krijimi i një plani finanziar në bazë të informacioneve dhe bazuar mbi nevojat që duhet të hartojnë njësitë bazë;
- Monitorimi i njëkohshëm i zbatimit të planit finanziar duke forcuar sistemin e brendshëm të kontrollit;
- Ngritura e kapaciteteve në strukturën e burimeve njerëzore dhe atë teknologjike duke pëmirësuar Sistemet softwear për menaxhimin e të dhënavë.

V. MONITORIMI I ARRITJES SË QËLLIMEVE

Qëllimet strategjike që reflektojnë orientimin themelor të ISHP-së do të trajtohen më hollësisht në programet vjetore të punës, ku do të bëhet e quartë lidhja ndërmjet qëllimeve vjetore dhe atyre strategjike. Në procesin e planifikimit të programeve vjetore të punës dhe monitorimin e zbatueshmërisë, do të përcaktohet gjithashtu dhe monitorimi i arritjes së qëllimeve strategjike. Kjo do të përfshihet edhe në planet vjetore të auditeve të brendshme.

Bazat për monitorimin e arritjes së qëllimeve janë treguesit dhe vlerat e synuara (target) të paraqitura më poshtë. Për çdo qëllim strategjik, ka të paktën një tregues të matshëm të zgjedhur në mënyrë që të jetë lehtësish i arritshëm dhe i rëndësishëm për një qëllim të caktuar. Shumica e treguesve janë përkufizuar në mënyrë që të mund të monitorohen çdo vit, për të patur qasje të vazhdueshme nga ana jonë në monitorimin e orientimit të përgjithshëm.

Referenca	Përshtkimi	Indikatori	Vlera target
Qëllimi strategjik1	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë krijuar një sistem për sigurimin e informacionit të përditësuar mbi shëndetin e popullsisë së Shqipërisë, përcaktuesit e shëndetit, dhe masat e nevojshme për përmirësimin e shëndetit.	Standardizimi i raporteve	çdo 2 vjet
		Analiza	>1 analizë çdo vit
		Përgatitja e raporteve	>5 çdo vit
Qëllimi strategjik2	Deri në vitin 2023, ISHP do të jetë burimi më i rëndësishëm i informacionit dhe partner qendror për sektorë të ndryshëm për formimin e politikave shëndetësore dhe programeve të përmirësimit të shëndetit.	Programet e zhvilluara	>1 çdo vit
		Propozimet prioritare	>4në pesë vjet
Qëllimi strategjik3	Deri në vitin 2023, ISHP do të përmirësojë dhe përsosë sigurimin aktual të të dhënavë dhe informacionit mbi funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë sigurimin e informacioneve kyçë shëndetësore dhe ekonomike dhe informacionit që ka të bëjë me cilësinë e kujdesit shëndetësor.	Standardizimi i raporteve	>1 çdo vit
		Analizë e funksionimit të sistemit shëndetësor	1 çdo 2 vjet
		Përgatitja e raporteve	>1 çdo 2 vjet
Qëllimi strategjik4	Deri në vitin 2023, ISHP do të jetë bërë operatori i rrjetit të vlerësimit të teknologjisë shëndetësore (HTA) në Shqipëri, duke siguruar vlerësimin gjithëpërfshirës të shëndetit.	Përgatitja e vlerësimit të teknologjisë shëndetësore	>1 çdo vit

Plani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2021-2023

Referenca	Përshkrimi	Indikatori	Vlera target
Qëllimi strategjik5	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë zhvilluar një model për parandalimin e integruar dhe kujdesin e plotë të sëmundjeve kronike, dhe do të marrë rol udhëheqës në kujdesin shëndetësor parandalues në të gjitha fushat.	Vendosja e koordinimit kombëtar të programeve parandaluese	1çdo vit
		Përgatitja e protokolleve të programeve parandaluese	1çdo vit
Qëllimi strategjik6	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë forcuar rolin e tij si pika kryesore e informacionit për vlerësimin e rrezikut dhe zbutjen e sëmundjeve ngjitetë, duke siguruar mbështetje me ekspertë në hartimin dhe zbatimin e masave të nevojshme.	Vlerësimi i barrës së sëmundjes	1çdo 3 vjet vit
		Përgatitja e programeve për zbutjen e sëmundjeve ngjitetë	>1çdo 2 vjet
		Programet e zbatuara në një vit	10
Qëllimi strategjik7	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë ngritur një sistem për monitorimin e sëmundjeve të lidhura me mjedisin dhe faktorët e mjedisit që ndikojnë në shëndet, dhe do të sigurojë informacione të rëndësishme mbi mjedisin dhe shëndetin.	Përgatitja e studimeve epidemiologjike	1çdo 5 vjet
		Raport për mjedisin dhe shëndetin	1çdo 2 vjet
Qëllimi strategjik8	Deri në vitin 2023, ISHP do të jetë pika kryesore e referencës për koordinimin e përgjigjeve të shpejta ndaj kërcënimeve të shëndetit për shkak të shfaqjes së sëmundjeve ngjitetë, përhapjes së qëllimshme të agjentëve biologjikë, apo paraqitjes së sëmundjeve me originë të panjohur.	Krijimi i protokolleve të zbulimit të hershëm	>1çdo 2 vjet
		Vlerësimi i gatishmërisë	1 çdo dy vjet
		Raport mbi punën e skuadrës kombëtare të përgjigjes së shpejtë	Përshkrim
Qëllimi strategjik9	Deri në vitin 2023, ISHP do të krijojë një qendër kombëtare të shërbimit të informacionit lidhur me kujdesin shëndetësor për të menaxhuar bazat kombëtare të të dhënave të kujdesit shëndetësor, si dhe të sigurojë të dhëna dhe informacione me qëllim gjenerimin	Përgatitja e një klasifikimi uniform	1çdo vit
		Zbatimi i Shëndetit	1çdo 2 vjet

Plani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2021-2023

Referenca	Përshkrimi	Indikatori	Vlera target
	e raporteve ndërkontinentale, përvèç planifikimit dhe ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor në një mënyrë të lehtë dhe të zbatueshme.	Scoop automatik i të dhënavë	1 mbledhje/koleksion çdo 2 vjet
Qëllimi strategjik10	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë forcuar rolin e tij si qendra kryesore e informacionit për shëndetin publik e cila siguron që individët, profesionistët e shëndetit dhe vendimmarrësit janë të pajisur me informacion të paanshëm nëpërmjet komunikimit proaktiv, të përditësuar dhe transparent.	Kontribut për Revistën e Shëndetit Publik dhe Buletinin	>1 për çdo volum per çdo organ
		Numri i vizitave të faqes së internetit	150 çdo vit
		Trajinim i organizuar për ata që ofrojnë informacion për publikun	1 çdo vit
Qëllimi strategjik11	Deri në vitin 2023, ISHP do të jetë një ofrues qendror trajnimi në shëndetin publik dhe një partner i rëndësishëm në arsimin parauniversitar dhe pasuniversitar të profesionistëve të shëndetit publik.	Forcimi i kapaciteteve mësimore të arsimit të lartë	Të paktën 1 çdo 2 vjet
		Punësimi i pjesshëm në Fakultetin e Mjekësisë	≥8
		Ekspertët të përfshirë në trajnim	Të paktën 90%
Qëllimi strategjik12	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë rritur kontributin e tij për shëndetin publik nëpërmjet vëllimit më të madh dhe suksesit të aktiviteteve të tij të kërkimit shkencor.	Rritja e buxhetit për projektet kërkimore shkencore	>10 % çdo 2 vjet
		Numri i kërkuesve që plotësojnë kriteret për drejtues të projekteve kërkimore kryesore	Rritje gjatë viteve
		Numri i citimeve të pastra	Rritje gjatë viteve
Referenca	Përshkrimi	Indikatori	Vlera target
Qëllimi strategjik13	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë hartuar programe të strukturuara të bashkëpunimit me partnerët kyç në formën e partneriteteve me vlerë të shtuar për të gjithë.	Programe të përbashkëta	1 çdo vit
		Përgatitja e E-projekteve të përbashkëta të shëndetit	1 çdo 2 vjet

**Plani i Zhvillimit Strategjik të Institutit të Shëndetit Publik të Republikës së Shqipërisë për
periudhën 2021-2023**

Referenca	Përvizimi	Indikatori	Vlera target
Qëllimi strategjik14	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar, të jetë bërë një partner më i njojur dhe i respektuar në zhvillimin dhe projektet e kërkimit shkencor, dhe do të ketë zhvilluar kapacitetet për të drejtuar projekte ndërkombëtare.	Drejtimi i një projekti ndërkombëtar	1 çdo pesë vjet
		Ekspertë që trajnohen jashtë vendit (>3muaj)	>1 çdo vit
Qëllimi strategjik15	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë përmirësuar operacionet e tij të biznesit me punonjësit e arsimuar dhe trajnuar në mënyrë të përshtatshme dhe duke zhvilluar një mjeshtërim stimulues pune.	Shkëmbimi i njojurive midis punonjësve	Arritja e planeve vjetore
		Kënaqësia e punonjësve	Përmirësim i vlerësimit
		Lider të kualifikuar dhe trajnuar	100%
Qëllimi strategjik16	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë rritur efikasitetin e mjedisit të biznesit nëpërmjet modernizimit të proceseve të biznesit dhe përshtatjes së tyre me infrastrukturën e informacionit.	Listimi dhe përkufizimi i indikatorëve	100% në pesë vjet
		Përpunimi kompjuterik	Arritja e planeve të punës
		Metoda e punës së projektit	Rritje gjatë viteve
Qëllimi strategjik17	Deri në vitin 2023, ISHP do të ketë vendosur operacione financiare transparente dhe të qëndrueshme.	Devijimi i lejuar nga plani financiar	<±5%